



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered		26-11-2021	1 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	5687/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.Nr. 842/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti, anëtarë, me Rushit Kajtazi zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.842/2021, të datës 30.09.2021, të parashtruar nga _____ nga Prishtina, kundër Vendimit me numër protokoli 01052 të datës 20.09.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.842/2021 e datës 30.09.2021, e parashtruar nga ankuesi**
- II. Mbeten në fuqi Vendimi me numër protokoli 01052 i datës 20.09.2021, i Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.**

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 30.09.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimi me numër protokoli 01052, të datës 20.09.2021 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës për ndryshim të Aktit të Emërimit të datës 06.12.2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.10.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës (tutje SHKK), ndërsa me datë 14.10.2021, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me provat lidhur me çështjen në procedurë.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marrë parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-se, me Vendimin nr.49/2021 të datës 12.11.2021 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A.nr.842/2021 të datës 30.09.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.842/2021 të datës 30.09.2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 13KA/2 të datës 30.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Vendimin me numër protokollit 01052 të datës 20.09.2021; Vendimin me numër protokollit 01056 të datës 20.09.2021, Vendimin me numër protokollit të datës 14.09.2021, Vendimin me nr.0008 të datës 06.01.2016, 14.09.2021; Akt Emërimit e datës 06.01.2018; Vendimin me numër protokollit 1592 të datës 29.11.2018; Vendimin me numër protokollit 4182 i datës 14.11.2019, Vendimin me numër protokollit 295 të datës 28.02.2019, , vendimin më numër protokollit 1543 të datës 21.11.2018, Vendimin me numër protokollit 453 të datës 26.03.2021, Formuari për Vlerësimin e punës për vitin 2019 i datës 17.12.2019 për ankuesin; Formuari për Vlerësimin e punës per ankuesin 2020, 2019, 2018, 2016 2017.2013, 2014,për vitin 2020 i datës 30.12.2019 për ankuesin, Formuari për Vlerësimin e punës për vitin 2028 i datës 24.12.2018 për ankuesin, Formuari për Vlerësimin e punës për vitin 2020 i datës 30.12.2019 për ankuesin Vendimi i datës 20.09.2021; e-mailin e datës 18.11.2021, Vendimin me Nr. protokollit 0610 te Datës 09.01.2013 , Përgjigje në ankesë, me numër protokollit 5043/2021 e datës 14.10.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Kontratës së Punës Nr.097/QPP të datës 08.08.2008, është emëruar në pozitën e punës Udhëheqës për Administratë dhe Trajtim Psikiatrik të të Burgosurve në Klinikës Psikiatrike në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, e cila pozitë i është vazhduar me tej sipas Kontratës së datës 08.03.2010 dhe Kontratës së datës 01.08.2011.

Me Vendimin me nr.prot.0610 të datës 09.01.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, ankuesi është transferuar përkohësisht nga pozita e punës Udhëheqës për Administratë dhe Trajtim Psikiatrik në pozitën e punës Udhëheqës për Siguri në Qendrën e Paraburgim në Prishtinë, me kohëzgjatje prej 09.01.2013 deri 09.04.2013.

Nga pozita e Udhëheqësit për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, ankuesi transferohet në pozitë të njëjtë Udhëheqës për Siguri në Drejtorinë Qendrore të SHKK- së bazuar në Vendimin e datës 01.03.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

Organi i Punësimit me datë 01.08.2014, ka lëshuar për ankuesin Kontratën e punës për pozitën e punës Udhëheqës për Administratë dhe Trajtim Psikiatrik të të Burgosurve në Klinikës Psikiatrike në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, me kohëzgjatje nga data 01.08.2014 deri me 31.07.2019. Ndërsa, me datë 06.12.2017 organi i punësimit ka lëshuar në emër të ankuesit Akt Emërim të Përhershëm për pozitën e punës Udhëheqës për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Me tutje, nga shqyrtimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi bazuar në Vendimin me nr.prot.0008 të datës 06.01.2016 dhe Vendimin me nr.prot.1592 të datës 29.11.2018 të Drejtorit të Përgjithshme të SHKK-së, nga pozita e punës së Udhëheqësit për Siguri është caktuar ushtrues detyre (U.d) i Drejtorit të Drejtoratit për Operativë, Siguri dhe Transport të të Burgosurave në Zyrën Qendrore të SHKK-së. Kurse me Vendimin me nr.prot.295 të datës 28.02.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, ankuesi është emëruar U.d i Drejtorit të Burgut për Siguri të Lartë, e cila pozitë i është vazhduar me Vendimin nr.prot. 4182 të datës 14.11.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së.

Me datë 14.09.2021 Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së, me Vendimin me nr.prot.01027, ka shfuqizuar Vendimin me nr.prot. 4182 të datës 14.11.2019, duke kthyer ankuesin nga U.d i Drejtorit të Burgut për Siguri të Lartë në pozitën e punës Udhëheqës për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë. Pas këtij vendimi, Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së nxjerrë Vendimin nr.prot.01056 të datës 20.09.2021, me të cilin ndryshohet pika dy (2) e Vendimit me nr.prot.01027 i datës 14.09.2021, ashtu që ankuesi është caktuar në pozitën Udhëheqës për Administratë në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me Vendimin me nr.prot.01052 të datës 20.09.2021 ka ndryshuar Akt Emërimin e ankuesit të datës 06.12.2017, ne atë mënyrë që është ndryshuar pozita e punës Udhëheqës për Siguri në Udhëheqës për Administratë. Ky ndryshim bazohet në faktin se nuk është gjetur asnjë vendim lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e akt emërimit për ndërrimin e pozitës nga Udhëheqës për Administratë në Udhëheqës për Siguri.

Kundër Vendimit me nr.prot.01052 të datës 20.09.2021 për ndryshimin e Akt emërimit të datës 06.12.2017, ankuesi brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë në KPMSHCK, duke pretenduar se ekzistojnë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale dhe shkelje thelbësore të së drejtas materiale. Me tej, ka theksuar se Akt Emërimi i datës 06.12.2017 është bazuar në Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së të datës 01.03.2013. Propozon që Këshilli duke pas parasysh parimet e meritokracisë, profesionalizmit dhe përvojës së punës së ankuesit, të njëjtin ta kthej në vendim e punës sipas Akt Emërimit të datës 06.12.2017 gjegjësisht në pozën e punës "Udhëheqës për Siguri" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, bazuar në nenin 3 paragraf 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka konstatuar se me dispozitat e këtij ligji vetëm personeli i Shërbimit Korrektues është trajtuar me status të shërbyesit civilë, ndërsa sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2021 përkatësisht duke u bazuar në nenin 4 paragrafi 1 të këtij Ligji ku thuhet se: *Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë*, Kolegji ka konstatuar se me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjithë nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësit civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civil si dhe ligjeve të veçanta.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesë, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 32 paragrafi 2 dhe 3 me të cilin është përcaktuar se: *2. Marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil themelohet me aktin e emërimit dhe, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj, është e përhershme (me afat të pacaktuar).3.Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*", dhe mbi këtë bazë Kolegji rikujton se marrëdhënia e punës në shërbimin civil është e përhershme dhe së çdo ndryshim lidhur me marrëdhënien e punës mund të behët vetëm në pajtim me dispozita ligjore të këtij ligji.

Bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës, Kolegji vlerëson së është i pa bazuar pretendimi ankimor se Akt emërimi i datës 06.12.2017 është bazuar në vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me Nr.prot.0610 të datës 09.01.2013, për faktin se, me Vendimin në fjalë është bërë vetëm transferimi i përkohshëm i ankuesit nga pozita e punës se Udhëheqësit për Administrata dhe Trajtim Psikik të të Burgosurve në pozitën e punës Udhëheqës për Siguri, për periudhën nga data 09.01.2013 deri me 09.04.2013, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se Vendimi me nr.prot. 0610 i datës 09.01.2013 për transferimin e përkohshëm të ankuesit nuk përbenë bazë ligjore për sistemin gjegjësisht emërimin e përhershëm të ankuesit nga pozita e punës "Udhëheqës për Administratë" në pozitën e punës "Udhëheqës për Siguri" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Referuar konstatimit si me lart si dhe duke marrë parasysh dispozitat e nenit 28 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren Nr.06/2010 mbi transferimin e nëpunësve Civil përkatësisht neni 3 paragrafi 1.1, nenin 4 paragrafi 2 dhe nenin 5 paragrafi 3, Kolegji konstaton së transferimi i përkohshëm është lëvizje e nëpunësit civil për një periudhë kohore deri në dymbëdhjetë (12) muaj dhe se me mbarimin e kohës së transferimit, nëpunësi civil kthehet në vendin paraprak të punës, e mbi këtë bazë rrjedhë së Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me rastin e nxjerrjes së Vendimit të ankimuar ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore përkatëse.

Po ashtu, lidhur me trajtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji ka analizuar edhe dispozitat e nenit 83 paragrafi 10 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *"Hyrja në fuqi e këtij ligji përbenë shkak ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës me ushtruesit e përkohshëm të detyrës së zyrtarëve publikë. Ushtruesit e detyrës kthehen në vendin punës"*, e mbi këtë bazë ligjore si dhe bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson se janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit Burim Buleshkaj.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nënin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr. 842/2021

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së;
- Udhëheqësit të Personelit të SHKK-së;
- Arkivit të KPMSHCK-së

